



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

**Vendosi:** Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 12 nëntor 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Gjykatësit të Vetëm**

---

**Gjykatësit të Vetëm**

Gjykatës Kristofer Gosnell

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Sofi Menegon

Luka Mishetiç

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Bashkim Smakajt**

Xhonatan Ris

Hju Bauden

**Mbrojtjes së Isni Kilajt**

Ian Eduards

Xho Holms

**Mbrojtjes së Fadil Fazliut**

Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Hajredin Kuçit**

Aleksandër Admiral

**GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 39 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 95(2) dhe 98(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi, pjesërisht, Aktakuzën kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Bashkim Smakajt (“z. Smakaj”), Isni Kilajt (“z. Kilaj”), Fadil Fazliut (“z. Fazliu”) dhe Hajredin Kuçit (“z. Kuçi”) (“Vendimi i Konfirmimit”).<sup>2</sup> Të njëjtën ditë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu lëshoi fletarrestime për z. Thaçi, z. Smakaj, z. Kilaj dhe z. Fazliu, dhe një fletëthirrje për paraqitje për z. Kuçi.<sup>3</sup>

2. Më 5 dhjetor 2024, z. Smakaj, z. Kilaj dhe z. Fazliu u arrestuan në Kosovë.<sup>4</sup> Të njëjtën ditë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) i dorëzoi fletëthirrjen për paraqitje z. Kuçi,<sup>5</sup> dhe i dorëzoi fletarrestimin z. Thaçi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 313. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

<sup>3</sup> KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse* (“Vendimi mbi Arrestimin dhe Fletëthirrjen për Paraqitje”), 29 nëntor 2024, konfidencial, me shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; Versioni i redaktuar publik i vendimit u lëshua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#).

<sup>4</sup> KSC-BC-2023-12, F00042, Administratorja, [Notification of Arrest of Bashkim Smakaj Pursuant to Rule 55\(4\)](#), (Njoftim i Arrestimit të Bashkim Smakajt sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik. KSC-BC-2023-12, F00043, Administratorja, [Notification of Arrest of Isni Kilaj Pursuant to Rule 55\(4\)](#) (Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik. KSC-BC-2023-12, F00045, Administratorja, [Notification of Arrest of Fadil Fazliu Pursuant to Rule 55\(4\)](#) (Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2023-12, F00046, Administratorja, [Notification of Service of Summons to Appear on Hajredin Kuçi](#), (Njoftim i Dorëzimit të Fletëthirrjes për Paraqitje Hajredin Kuçit), 5 dhjetor 2024, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2023-12, F00048, Administratorja, [Notification of Service of Arrest Warrant on Hashim Thaçi Pursuant to Rule 55\(4\)](#) (Njoftim i Dorëzimit të Fletarrestimit Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik.

3. Më 6 dhjetor 2024, z. Smakaj, z. Kilaj dhe z. Fazliu u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara,<sup>7</sup> sipas urdhrit të Gjykatës së Procedurës Paraprake.<sup>8</sup>
4. Më 3 prill 2025, pasi i miratoi ZPS-së leje për apelim të Vendimit të Konfirmimit<sup>9</sup>, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin e vet mbi apelin e ZPS-së dhe i ktheu një aspekt Gjykatës së Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm.<sup>10</sup>
5. Më 14 prill 2025, në vijim të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi Vendimin e Konfirmimit, urdhëroi ZPS-në të dorëzonte aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar dhe caktoi datën 8 maj 2025 si datë të dorëzimit të mocioneve paraprake të Mbrojtjes.<sup>11</sup>

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2023-12, F00056, Administratorja, [Notification of Reception of Isni Kilaj in the Detention Facilities of the Specialist Chambers](#) (Njoftim i Pranimit të Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara), 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. F00057, Administratorja, [Notification of Reception of Fadil Fazliu in the Detention Facilities of the Specialist Chambers](#) (Njoftim i Pranimit të Fadil Fazliut në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara), 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. F00058, Administratorja, [Notification of Reception of Bashkim Smakaj in the Detention Facilities of the Specialist Chambers](#) (Njoftim i Pranimit të Bashkim Smakajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara), 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> *Shih* Vendimin mbi Arrestimin dhe Fletëthirjen për Paraqitje, para. 106-108.

<sup>9</sup> KSC-BC-2023-12, F00149, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Specialist Prosecutor's Request for Leave to Appeal the "Decision on the Confirmation of the Indictment"](#) (Vendim mbi Kërkesën e Prokurores së Specializuar për Leje për Apelin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës), 30 janar 2025, publik. IA002/F00002, Prokurorja e Specializuar, *Apel i Prokurorisë kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës (F00036)*, 12 shkurt 2025, konfidencial, me Shtojcat [1](#) dhe [2](#), publike. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 14 shkurt 2025, [IA002/F00002/RED](#).

<sup>10</sup> KSC-BC-2023-12, IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA002/F00012/RED.

<sup>11</sup> KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmim e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

6. Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ("Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar").<sup>12</sup>
7. Më 19 qershor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi mocionin paraprak të Mbrojtjes së z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") mbi juridiksionin ("Vendimi mbi Mocionin Paraprak lidhur me Juridiksionin").<sup>13</sup>
8. Më 24 qershor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi mocionet paraprake për mangësi në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar të dorëzuara nga Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e z. Fazliu ("Mbrojtja e Fazliut") ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë").<sup>14</sup>
9. Më 30 qershor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi mocionin paraprak të Mbrojtjes së Thaçit ku kërkohet veçim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar dhe shtyrje e procesit gjyqësor në lidhje me z. Thaçi ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor").<sup>15</sup> Në të njëjtin vendim, ajo gjithashtu rrëzoi mocionin paraprak të përbashkët, të dorëzuar nga Mbrojtja e z. Smakaj ("Mbrojtja e Smakajt"), Mbrojtja e z. Kilaj ("Mbrojtja e Kilajt"), Mbrojtja e Fazliut dhe Mbrojtja e z. Kuçi ("Mbrojtja e Kuçit"), ku kërkohet veçimi i akuzave.<sup>16</sup>

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, [Submission of Amended Confirmed Indictment \(Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar\)](#), 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përfshin versionin konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), dhe [Annex 2 \(Shtojcën 2\)](#), publike (që përfshin versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

<sup>13</sup> KSC-BC-2023-12, F00343, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Thaçi Defence Preliminary Motion on Jurisdiction](#) (Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin), 19 korrik 2025, publik;

<sup>14</sup> KSC-BC-2023-12, F00347, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Preliminary Motions Alleging Defects in the Indictment](#) (Vendim mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë), 24 qershor 2025, publik.

<sup>15</sup> KSC-BC-2023-12, F00354, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor*, 30 qershor 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 1 korrik 2025, [F00354/RED](#).

<sup>16</sup> *Shih* Vendimin mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor, para. 77(b).

10. Më 23 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake autorizoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për leje për apelimin e Vendimit mbi Mocionin Paraprak lidhur me Juridiksionin.<sup>17</sup> Të njëjtën ditë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu autorizoi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për leje për apelimin e Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor.<sup>18</sup>
11. Më 24 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesat e Mbrojtjes së Thaçit dhe të Mbrojtjes së Fazliut për leje për apelimin e Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë.<sup>19</sup>
12. Më 16 shtator 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, ndër të tjera, (i) ftoi ekipet e Mbrojtjes që, deri më 20 tetor 2025, të dorëzonin dosjet paraprake të tyre dhe të njoftonin ZPS-në për synimin e tyre për të paraqitur arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale, dhe (ii) informoi palët se dosja e çështjes pritej t'i kalohej Trupit Gjyqësor në gjysmën e parë të nëntorit 2025.<sup>20</sup>
13. Më 19 shtator 2025, ZPS-ja dorëzoi dosjen e saj paraprake, së bashku me, ndër të tjera, listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale.<sup>21</sup>

---

<sup>17</sup> KSC-BC-2023-12, F00391, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Thaçi Defence Request for Certification to Appeal the "Decision on the Thaçi Defence Preliminary Motion on Jurisdiction"](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin), 23 korrik 2025, publik.

<sup>18</sup> KSC-BC-2023-12, F00390, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor*, 23 korrik 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, [F00390/RED](#).

<sup>19</sup> KSC-BC-2023-12, F00392, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Thaçi and Fazliu Requests for Certification to Appeal the "Decision on Preliminary Motions Alleging Defects in the Indictment"](#) (Vendim mbi Kërkesat e Thaçit dhe të Fazliut për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë), 24 korrik 2025, publik.

<sup>20</sup> KSC-BC-2023-12, F00453, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Remaining Calendar of the Pre-Trial Proceedings](#) (Vendim mbi Pjesën e Mbetur të Kalendarit të Fazës Paraprake), 16 shtator 2025, publik, para. 23(a), (b) dhe (e).

<sup>21</sup> *Shih* KSC-BC-2023-12, F00459, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, publik, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i korrigjuar i Dosjes Paraprake të ZPS-së, së bashku me Shtojcat konfidenciale 1-5, u dorëzuan më 26 shtator 2025, F00467. Versioni i korrigjuar i Dosjes Paraprake,

14. Më 17 tetor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën e Mbrojtjes së Kilajt, të cilës iu bashkua dhe Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Kuçit, për ndryshimin e afateve për dorëzimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes.<sup>22</sup>
15. Më 19 dhe 20 tetor 2025, Mbrojtja e Smakajt, Mbrojtja e Fazliut dhe Mbrojtja e Thaçit dorëzuan dosjet paraprake përkatëse të tyre.<sup>23</sup>
16. Më 28 tetor 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë dy apele të Mbrojtjes së z. Thaçi kundër Vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi Mocionin Paraprak lidhur me Juridiksionin dhe Vendimin mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor (“Vendimi mbi Apelet në lidhje me Mocionet Paraprake të Mbrojtjes së Thaçit”).<sup>24</sup>
17. Më 3 nëntor 2025, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një njoftim ku informoi Gjykatësen e Procedurës Paraprake lidhur me synimin e vet për të paraqitur një kërkesë referuese para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 49(3) të Ligjit (“Njoftimi i Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Synimin për Paraqitjen e Kërkesës Referuese sipas Nenit 49” ose “Njoftimi”).<sup>25</sup>

---

së bashku me Shtojcat konfidenciale 1-5, u ridorëzuan më 6 tetor 2025, me hollësitë, në një shënim shpjegues, të korrigjimeve të bëra në dosjen paraprake të ZPS-së dhe Shtojcën 4 (Listën e Provave Materiale), F00459/COR. Versioni i redaktuar publik i Dosjes Paraprake u dorëzua më 7 tetor 2025, F00489, me Shtojcën 1, publike.

<sup>22</sup> KSC-BC-2023-12, F00512, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Kilaj Request for Extension of Time to Submit Defence Pre-Trial Brief](#) (Vendim mbi Kërkesën e Kilajt për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes), 17 tetor 2025, publik.

<sup>23</sup> KSC-BC-2023-12, F00513, Mbrojtja e Smakajt, *Dosja Paraprake e Smakajt në përputhje me Rregullën 95(5)*, 19 tetor 2025, konfidenciale; F00517, Mbrojtja e Fazliut, *Dosja Paraprake e Fazliut*, 20 tetor 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, F00517/RED. F00518, Mbrojtja e Thaçit, *Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Thaçit*, 20 tetor 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 tetor 2025, F00518/RED.

<sup>24</sup> KSC-BC-2023-12, IA006, F00009, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin dhe Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit Gjyqësor*, 28 tetor 2025, publik.

<sup>25</sup> KSC-BC-2023-12, F00535, Mbrojtja e Thaçit, *Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Synimin për Paraqitjen e Kërkesës Referuese sipas Nenit 49*, 3 nëntor 2025, publik.

18. Më 11 nëntor 2025, në bazë të rregullës 98(3) të rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren se dosja e çështjes gjyqësore do të ishte e gatshme për t'iu kaluar Trupit Gjykses të premtën, më 12 nëntor 2025.<sup>26</sup>

19. Më 12 nëntor 2025, Kryetarja lëshoi vendimin për caktimin e gjykatësit Kristofer Gosnell si Gjykatës të Vetëm pas kalimit të dosjes së çështjes gjyqësore.<sup>27</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

20. Sipas nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë të nxjerrë çdo urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

21. Sipas rregullës 95(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që të mos ketë vonesa të papërligjura të procedimit dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.

22. Sipas rregullës 98(1) të Rregullores, pas marrjes së dosjeve paraprake, listave të dëshmitarëve dhe listave të provave materiale përkatëse nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja bazuar në rregullën 95(4) dhe (5) të Rregullores, dhe brenda tridhjetë (30) ditësh pas daljes së çdo vendimi të formës së prerë në lidhje me mocione paraprake, gjykatësi i procedurës paraprake i kalon trupit gjykses dosjen e plotë të çështjes gjyqësore, e cila përmban

(a) Aktakuzën e konfirmuar;

(b) Të gjitha parashtrimet dhe materialet e dorëzuara nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit gjyqësor;

(c) Çfarëdo provash të administruara që nuk përmenden në [rregullën 98(1)(b)];

---

<sup>26</sup> KSC-BC-2023-12, F00541, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Njoftim sipas Rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*, 11 nëntor 2025, publik.

<sup>27</sup>KSC-BC-2023-12, F00543, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm*, 12 nëntor 2025, publik.

- (d) Çfarëdo letërkëmbimi në lidhje me çështjen që nuk është dorëzuar në Njësinë e Administrimit të Gjykatës;
- (e) një dokument dorëzues që përfshin:
- (i) argumentet e palëve dhe nëse është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, në lidhje me faktet dhe ligjin përkatës;
  - (ii) pikat për të cilat palët pajtohen;
  - (iii) listën e urdhrave dhe vendimeve të dhëna nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake;
  - (iv) provat e paraqitura nga secila palë;
  - (v) sugjerime në lidhje me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren;
  - (vi) pikat e kundërshtuara faktike dhe ligjore;
  - (vii) ecurinë e nxjerrjes së materialeve;
  - (viii) të gjitha mbledhjet me palët; dhe
  - (ix) çfarëdo çështje tjetër të pazgjidhur;
- (f) kërkesa dhe vendime në lidhje me nxjerrjen e materialit; dhe
- (g) çfarëdo materiali tjetër që ka lidhje me çështjen.

23. Sipas rregullës 98(2) të Rregullores, kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore kryhet në mënyrë elektronike.

### III. DISKUTIM

24. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se janë kryer të gjithë hapat proceduralë të nevojshëm, për aq sa është e mundshme në këtë fazë, për ta konsideruar dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2023-12 të plotë.

25. Gjithashtu, pavarësisht nga Njoftimi i Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Synimin për Paraqitjen e Kërkesës Referuese sipas Nenit 49, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, duke marrë parasysh Vendimin e Panelit të Gjykatës së

Apelit mbi Apelet në lidhje me Mocionet Paraprake të Mbrojtjes së Thaçit, vendimet mbi mocionet paraprake të ngritura në kontekstin e këtij procesi gjyqësor janë të formës së prerë<sup>28</sup> sipas kuptimit të rregullës 98(1) të Rregullores.

26. Duke marrë parasysh natyrën e shpejtë të procesit sipas nenit 15(2),<sup>29</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se dosja e çështjes gjyqësore është e gatshme për t'iu kaluar Gjykatësit të Vetëm, në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.

27. Në përputhje me rregullën 98(1) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka përgatitur një dokument dorëzues që përmban informacionin e përshkruar në rregullën 98(1)(e) të Rregullores, për Gjykatësin e Vetëm dhe palët. Gjykatësja e Procedurës Paraprake sqaron se, për shkak të informacionit jopublik

---

<sup>28</sup> Vendimet e Panelit të Gjykatës së Apelit që nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në shkallë të tretë para një Paneli të Gjykatës Supreme, janë të formës së prerë. (shih KSC-CC-2022-14, F00009, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Decision on the Referral of Jakup Krasniqi Concerning the Legality of Charging Joint Criminal Enterprise and the Referral of Kadri Veseli Concerning Decision of the Appeals Panel on Challenges to the Jurisdiction of the Specialist Chambers](#) (Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara), 13 qershor 2022, publik, para 56; KSC-CC-2022-15, F00010, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Decision on the Referral of Hashim Thaçi Concerning the Right to an Independent and Impartial Tribunal Established by Law and to a Reasoned Opinion](#) (Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit në lidhje me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsjetuar), ("Vendimi mbi Kërkesën Referuese të z. Thaçit lidhur me të Drejtën për Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme"), 13 qershor 2022, publik, para. 66-67; KSC-CC-2022-16, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Decision on the Referral of Pjetër Shala to the Constitutional Court Panel Concerning Fundamental Rights Guaranteed by Article 33 of the Kosovo Constitution and Article 7 of the European Convention on Human Rights](#) (Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të Drejtat Themelore të tij të Garantuara nga Neni 33 i Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), 6 korrik 2022, publik, para. 51. Kjo vlen edhe nëse nisat proces para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, që është autoriteti përfundimtar *vetëm* në lidhje me pretendimet për shkelje nga DHS-ja dhe ZPS-ja të të drejtave dhe lirive individuale të të akuzuarve dhe viktimave, të garantuara nga Kushtetuta (neni 49(3) i Ligjit; shih gjithashtu KSC-CC-2019-05, F00012, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Decision on the Referral of Mahir Hasani Concerning Prosecution Order of 20 December 2018](#), (Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018), 20 shkurt 2019, para. 50; Vendimi mbi Kërkesën Referuese të z. Thaçit lidhur me të Drejtën për Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme, para. 41).

<sup>29</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, sipas rregullës 72(1) të Rregullores, një dosje çështjeje gjyqësore sipas nenit 15(2) mund t'i kalohet Trupit Gjykues "menjëherë pas daljes së vendimeve në lidhje me mocionet paraprake".

që përmban dokumenti dorëzues, këtij vendimi i bashkëngjitet versioni konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i dokumentit dorëzues.

#### IV. VENDIM

28. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia **KALON** dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2023-12 Gjykatësit të Vetëm, së bashku me dokumentin dorëzues bashkëngjitur këtij vendimi.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Marzhori Masëlo**  
**Gjykatëse e Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 12 nëntor 2025

Në Hagë, Holandë.